



Shkodër, 25.04.2019

Thirrje për printim materiale vizibiliteti

Pozicioni: Studio Grafike-Printim dhe dizenjim
Titulli i projektit: “Youth WAVE for Human Rights”
Shtyrja e afatit të aplikimit: 12 Maj 2019

1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Projekti “Youth Wave for Human Rights” zbatohet në Shkodër në kuadër të Projektit “Të rinjtë në Shqipëri për të Drejtat e Njeriut” i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga World Vision në bashkëpunim me Rrjetin e të Rinjve Jugoro-Lindor. Ky projekt ka për qëllim aftësimin dhe fuqizojmin e të rinjve për të ndërtuar komunitete miqësore dhe respektuese ndaj të drejtave të njeriut dhe përfshin zhvillimin e një sërë aktiviteteve që i shërbejnë arritjes së këtij qëllimi.

2. Qëllimi i kontratës

Përcaktimi i termave të angazhimit të studios së printimit për përgatitjen e materialeve promocionale si postera dhe fletëpalosje.

3. Produkti i punës

Postera dhe fletëpalosje që do të shpërndahen në çdo aktivitet të projektit, me qëllim rritjen e ndjeshmërisë dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të Shkodrës për çështje që lidhen me të drejtat e njeriut. Këto material do të paraqesin punën që do të bëhet në zbatim të këtij projekti por në të njëjtën kohë edhe të adresojë çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut.

4. Vendi i zhvillimit të aktivitetit

Aktiviteti do të zhvillohet në hapësirën territoriale të Bashkisë Shkodër dhe Pukë, konkretisht Njesia Administrative Rrethina, Ana e Malit, Rajoni nr. 5 dhe Gomsiqe.

5. Roli dhe përgjegjësitë e studios grafike

Aktiviteti do të fillojë menjëherë me nënshkrimin e kontratës dhe konsiston në:

- Dizenjimin dhe hartimin e materialeve promocionale në përputhje të plotë me objektivat e projektit.
- Printimin e materialeve pas përfundimit grafik të tyre
- “Gruaja tek Gruaja” dhe stafi i angazhuar në projekt kanë fjalën e fundit lidhur me produktin final.

6. Kohëzgjatja e kontratës dhe planifikimi i punës

1. Aktiviteti nis menjëherë pas shpalljes/lajmerimit të fituesit
2. Afati për planifikimin dhe realizimin e punëve do të vendoset me marrëveshje mes ofruesit të shërbimit dhe koordinatorit të projektit.
3. Produkti final duhet të jetë i përfunduar deri me datën 10 Maj 2019.

7. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati

- Eksperiencë në fushën e punës dizenjim dhe printim
- Përdorimi i pakteve profesionale të dizenjimit
- Përdorimi i materialeve cilësore për prodhimet grafike
- Aftësi për të punuar brenda limiteve kohore të përcaktuara dhe me standarte të larta profesionalizmi.

8. Dokumentacioni i nevojshëm

- Materiale të cilat demonstrojnë eksperiencën në këtë fushë.
- Ekstrakt QKR;

9. Pagesa

Mënyra e pagesës do të kryhet varësisht nga vullneti i të kontraktuarit në përfundim të të gjitha detyrimeve të listuara apo me disa transhe duke i lidhur ato me detyra të përfunduara.

Procedura e prokurimit ka një fond limit prej 156'625 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtëmije e gjashtëqind e njëzet e pesë) Lekë. Subjekti i interesuar për t'iu përgjigjur ftesës për ofertë duhet të paraqesë ofertën e tij duke përdorur tabelën si më poshtë.

Nr.	Përshkrimi i produktit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Poster	Copë	100		
2	Fletëpalosje	Copë	1500		
	Totali				

10. Aplikimi

Aplikimi/oferta duhet të dërgohet brënda datës 12.05.2019 me email në adresën: grujatekgrujaja@gmail.com.